

**AKT TEMELIMI & STATUT I SHOQËRISE
ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “VATEK-AL” SH.P.K.**

Në këtë statut

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, ndyshuar;
- “Statuti” është Statuti i shoqërisë “VATEK-AL SH.P.K”.

**KREU I
THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA**

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, më datë 15 Shkurt 2019, Hikmet Sinan İNAL, atesia Ibrahim, datelindja 13.08.1978, lindur ne Stamboll Turqi dhe banues ne Tirane, Rruga “3 Deshmoret”, Pall “Sina Konstruksion 2008”, Kati 8, Apt. 36, me numer leterjoftimi 031782016 dhe nr personal H80813181N, me shtetësi shqiptare madhor e me zotesi te plote juridike dhe zotesi te plote per te vepruar në ora 13:00 vendos themelimin e Shoqerise “VATEK-AL” SH.P.K.

- Data e themelimit te shoqerise “VATEK-AL” shpk eshte data **15 Shkurt 2019**
- Kjo shoqeri do te jete **Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar**.
- Themeluesit te Shoqërisë është **İNAL, Hikmet Sinan**. Ortaket e shoqerise i kane te ndara **kuotat** si me poshte;
 - ✓ **Hikmet Sinan İNAL: 100%**

Neni 2

Selia

Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: **Rruga “Reshit Çollaku”, Pallati Nr. 38, Shkalla Nr. 1, Apartamenti 7, Kati 4 Tirane**. Shoqëria mund të krijojë degë (filiale) ose përfaqësi, si në rrethe të ndryshme të Republikës së Shqipërisë ashtu edhe në shtete të tjera, në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse.

Shqiperi, **numri i celularit per kontakt eshte +355696010050**

Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: **hikmetsinan@gmail.com**.


Neni 3

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

"Shoqëria merret me tregtimi me shumice dhe pakice i artikujve industriale, sistemeve, aparateve dhe filtrave per filtrimin e ujit, etj. Import-eksport i artikujve industriale, sistemeve, aparateve dhe filtrave per filtrimin e ujit, etj. Projektim te planeve rregulluese, ndertim te objekteve te ndryshme industriale, digash, galerish, tunelesh, ujesjellash, etj. Zbatim, studime pjesore, urbanistike, projektme te ndertimeve civile, industriale, turistike, bujqesore,etj.

Shoqëria mund te ngreje dhe mund te vere ne pune fabrika, kantjere, servisi si dhe stacione testimi dhe gjithashtu te transferoje keto ambjente dhe te ngreje ambjente te levizshme, ajo mundet te tregtoje prodhimet e veta ne tregun vendas dhe te huaj, te bleje dhe te marre me qira ambjente, magazina dhe vende prodhimi nga personat e trete dhe Institucionet Shteterore dhe t'i zgjeroje keto ambjente ne perputhje ne objektin e veprimtarise se shoqerise. Te hyje ne partneritet me shoqerite e tjera apo individe brenda objektit te shoqerise apo te behet ortak te veproje si perfaqesues ose te autorizojë perfaqesues dhe agjente si dhe te kontraktoje per keto ceshtje. Te bleje nga furnizues vendas apo te huaj makineri dhe pajisje dhe/ose mjete materiale per te prodhuar keto makinerie pajisje, te cilat nevojiten per realizimin e objektivave ekonomike



dhe aktivitetit operacional te shoqerise. Te perfshihet ne aktivitet kerkimore, zhvillimi, trajnimi, planifikim-projektim-zbatim dhe te tjera aktivitetete ngjashme. Te bleje, te shese, ndertoje, te jape e marre me kredi apo te perdore me cdo menyre te ligjshme te gjitha llojet e pronave te luajtshme e te paluajtshme, te vendose pengje, hipoteka, uzufrukte apo cdo barre tjeter ne pronate veta te luajtshme e te paluajtshme si garancite detyrimeve te veta apo edhe te treteve. Te nxjerre, publikoje, shperndaje revista, broshura, libra, cd dhe botime digitale ne lidhje me sektorin e vete dhe nepermjet sherbimeve te paleve te treta per keto botime. Te marre te gjitha llojet e kredive afat shkurter, afat mesem apo afat gjate nga ente vendase apo te huaja me apo pa titull financiare.

Shoqeria munde merret me import, eksport, tregtime me shumice dhe pakice brenda vendit materialeve dhe produkteve, ushqimore, industriale, kimikate si dhe produktet te tjera.

Projektme, studime fizibiliteti dhe ndertime tunelesh, pusesh, minierash, objektesh industriale dhe jo-industriale. Kerkimi, zbulimi, shfrytezimi dhe perpunimi i mineraleve te dobishme dhe tregtimi i tyre brenda dhe jashte vendit. Import eksport, tregtim me shumice e pakice te mallrave te ndryshme industriale, materialet e ndertimit, produkteve bujqesore, blegtorale, ushqimore etj. Import dhe tregtim me shumice pakice te automjeteve dhe mjeteve minierash, ndertimore te llojeve dhe tonazheve te ndryshme dhe pjeseve te kembimit per to.”

Për kryerjen e aktivitetit të shoqërisë së mesipërme, për te cilin do të nevojitet leje përkatëse, shoqëria është e detyruar të pajiset paraprakisht me këtë leje nga organi kompetent.

Neni 4 Kohëzgjatja

Kompania e zhvilloje veprimtarine pa afat.

KREU II KAPITALI

Neni 5 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100,000 Lekë.

Ortaku themelues eshte Z. Hikmet Sinan İNAL: Zoterues i 1 (nje) kuota me vlerë të përgjithshme 100,000 leke (qind mije leke) që përben 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortaku eshte në para qe do te mbahet ne arken e Kompanise.

Neni 6: Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga QKB-ja kompetente e nje eksperti kontributesh sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga ortakët, i cili merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit me 100% te votave.

Në të gjitha rastet, zvogëlimi prek ortakun në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqëson.



Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve (ortaket egzistues ose ortaket të rinj që mund të shtohen).

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Ortaku i Vetem është aktualisht organi i vetem vendimmarres i shoqërisë.

Ortaku i vetem është aktualisht organi i vetem vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Ortaku i vetem është përgjegjës për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin e ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.



Neni 10
Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 70 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11
Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasyqruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Neni 12
Përjashtimi nga e drejta e votës

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13
Administrimi



Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. **Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.** Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Emerohet si administrator i parë i shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Të dhënat e identifikimit:

ËNAL, Hikmet Sinan,
Rr."3 Deshmoret", Pall.E-88,
Shk.C-1, Apt.29, TIRANE

dhe specimenët e nënshkrimit:

Neni 14

Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratorët janë të detyruar të therasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

Përgjegjësia e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;



d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KREU IV VITI FINANCIAR-EKSPERTET

Neni 16

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertet

Eksperti, kur Shoqëria plotesone kushtet ligjore dhe statutore per te patur ekspert, ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.



KREU V
PRISHJA –RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper”

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pagueuse, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19

Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.” ndryshuar.

Neni 20

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqerite tregtare" ndyshuar, Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqiperise.

Neni 21

Mosmarrëveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar.

O R T A K U V E T E M
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
VATEK-AL SH.P.K.

1. 